



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.96/2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), kryesuesi i panelit Muhamet Rexha, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër “TV Mitrovica” për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore në ditën e rivotimit në Mitrovicë të datës 23.01.2011, në seancën e panelit të mbajtur me 26.01.2011, mori këtë::

## V E N D I M

**APROVOHET** kërkesa për **TËRHEQJEN** e ankesës së subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV), e paraqitur kundër “TV Mitrovica” për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore në ditën e rivotimit në Mitrovicë të datës 23.01.2011.

## A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 23.01.2011, nga subjekti politik LVV, me te cilën pretendohet se më datë 23.01.2011, rreth orës 11:33 në “TV MITROVICA” ka transmetuar një këngë me spotin e kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) Hashim Thaçi. Më këtë parashtresë i ankesës konsideron se është shkelur neni 52 par.1 i LZP-së.

Parashtresë i ankesës më parashtresën Anr.98/2011 të datës 24.01.2011 e ka tërhequr ankesën në këtë çështje juridike.

PZAP-i e ka aprovuar tërheqjen e ankesës andaj konform me nenin 261 të LPK-së ka marrë vendim dhe ka vendos si në dispozitiv.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 96/2011 më datën 26.01.2011

Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha

